



KOMUNA E PODUJEVËS
MUNICIPALITY OF PODUJEVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPSTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DREKTORIA E ADM. NISTRAÇES - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më		
Dostavljeno 06-08-2025		
Njësi.org.	Nr.	Shtojcë -
Org. led.	Br.	Prilog
02-06/01-0042121/25		
PODUJEVË - PODUJEVO		

KOMPANIA UJËSJELLËSIT RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D.D.
PRISHTINA

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

E lidhur me datë __05/07/__2025, ndërmjet :

Komunës së Podujevës , përfaqësuar nga z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe

Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A., rr."Hazir Shala" nr.4, përfaqësuar nga z. Fidaïm Jashari Menaxheri NJOU Podujevë (në vazhdim të tekstit: Kompania)

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është realizimi i punimeve "Ndertimi i rrjetit në lagjen Hyseni Aliu Marteta" në fsh Batllav të Komunës së Podujevës.

Neni 2 Obligimet e Komunës

1. Komuna me anë të këtij Memorandumi merr obligim të participoj në realizimin e këtij projekti në vlerë prej 15,000 € (pesëmbëdhjetë mijë euro)

Neni 3 Obligimet e Kompanisë

1 Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" Sh.A, merr për obligim të financoj Projektin në vlerë prej 55.000 € (Pesëdhjetë e pesë mijë euro)

2 Me anë të këtij Memorandumi, Kompania dhe Komuna marrin obligim që të financojë punimet kryera në kuadër të projektit.

Neni 4

Zhvillimi i procedurave të prokurimit

1. Procedurat e prokurimit do të zhvillohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, të cilat do të udhëhiqen nga KRU Prishtina.
2. Disbursimi i mjeteve nga Komuna do të bëhet tek Kontraktori pas pranimi të situacioneve të kryerjes së punimeve të aprovuara nga Mbikëqyrësi i Projektit, e më pas Komuna i transferon mjetet tek Kontraktori.

Neni 5

Mbikëqyrja e punimeve

Mbikëqyrja e kontratës do të kryhet nga të dy palët e këtij Memorandumi, ku secili do të caktojë nga një person për mbikëqyrje të punimeve

Neni 6

Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim nga të dy palët.
2. Në rast të çfarëdo paqartësie (kontesti) të këtij Memorandumi të mirëkuptimit, secila palë obligohet të njoftoj palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën me të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga ky Memorandum Mirëkuptimi. Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim, atëherë pala mundë të adresojë çështjen në gjykatën kompetente.

Neni 8

Hyrja në fuqi

1. Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët .
2. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

z. Shpejtim Bulliqi
Kryetar i Komunës së Podujevës



z. Fidaim Jashari
Menaxher KRU "Prishtina" sh.a NJOU Podujevë

